



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P. 634/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.09.2018, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-63369-04-18-2018, Loti II, me objekt “Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 86.582.118. lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara – Ministria e Brendshme.

**Ankimues:**

“Sori - Al” sh.p.k.  
Rruga “Beqir Luga”, Pallati Nr. 3, Shk. 1/1, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Ministria e Brendshme (Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara)  
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë

**Subjekt i interesuar:**

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k.  
Rruga “Fortuzi”, Apart.1, Kati 1, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.04.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-63369-04-18-2018, Loti II, me objekt “Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 86.582.118 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 21.05.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- |    |   |                                   |
|----|---|-----------------------------------|
| 1. | Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Clean & Fast” sh.p.k.<br>& ”Duka” sh.p.k. | 66.927.731,85 lekë, kualifikuar   |
| 2. | Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” sh.p.k.                             |                                   |
| 3. | & ”Borshi” sh.p.k.  | 68.584.282 lekë, skualifikuar     |
| 4. | “Pastrime Silvio” sh.p.k.   | 78.269.204,55 lekë, skualifikuar  |
| 5. | “Fusha” sh.p.k.   | 80.477.679,33 lekë, skualifikuar  |
| 6. | ”Sori - Al” sh.p.k.   | 85.272.764,13 lekë, kualifikuar   |
| 7. | ”Adem Pojani” sh.p.k.   | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 08.06.2018 operatori ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 13.06.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean & Fast” sh.p.k. & ”Duka” shpk., duke ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

[...]

*Bazuar në informacionin që disponojmë, na rezulton se ky operator ekonomik ka ofertuar si bashkim operatorësh ekonomikë për këtë procedurë prokurimi dhe referuar kriterëve të kërkuara nga autoriteti juaj kontraktor shoqëria jonë pretendon se:*

- 1. Ofertuesi Clean Fast nuk plotëson kriterin për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, pasi vlera mesatare e xhiros së tij nuk plotëson vlerën sipas përqindjes së pjesëmarrjes në marrëveshjen e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “Bashkimi i Operatorëve ekonomikë”, pikës 3, ku parashikohet [...].*
- 2. Operatori ekonomik “Duka” sh.p.k. nuk plotëson kriterin e kapacitetit ligjor pasi në ekstraktin e regjistrit të shoqërisë nuk përfshihet objekti që prokurohet “Pastrim i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme”. Ky pretendim bazohet në ekstraktin e shoqërisë shkarkuar nga QKB ku përcaktohet se objekt i veprimtarisë së shoqërisë “Duka” sh.p.k. është: “Prodhim të materialeve të ndërtimit, ndërtime e shtrime rrugësh, punime dhe gërmime me makina të rënda, pune rrugësh dhe digash, shtrimesh, ndërtimit, servis makinash, pjesë këmbimi dhe çdo lloj tjetër punimi objektesh Shërbime komunale të të gjitha llojeve, tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, etj., Diferencim, riciklim i mbeturinave urbane. Vlerësim i ndikimit dhe impakti në mjedis, auditim dhe ekspertizë mjedisore, studim, projektim dhe zbatim të projekteve mjedisore.*

3. *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk ka dorëzuar deklaratë për drejtuesin teknik për kryerjen e shërbimit të marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka vërtetuar se ka të punësuar Agro – Ekologjist/Agronom duke mos dorëzuar kontratë pune/librezë pune /diplomë. Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 74, pika 3[...]*
4. *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk ka dorëzuar deklaratë për disponimin e mjeteve që do të angazhohen në këtë procedurë prokurimi.*
5. *Ofertuesi "Clean Fast" nuk plotëson kriterin për paraqitjen e bilancit të vitit 2015, bazur ky pretendim në ekstraktin e regjistrit tregtar të shoqërisë "Clean Fast" sh.p.k. ku vërtetohet se ky operator është regjistruar në datën 07.06.2016 (bashkëlidhur kopje e ekstraktit të shoqërisë). Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 74 "Bashkimi i Operatorëve ekonomikë" pikës 3, ku parashikohet se: Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje".*
6. *Përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" nuk plotëson kriterin për dorëzimin e çertifikatave ISO 9001-2008/ISO 9001-2015; ISO 18001:2007; ISO 14001:2004/ISO 14001:2015; pasi çertifikatat nuk janë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*
7. *Përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" nuk plotëson kriterin për leje mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për pastrimin, sistemimin e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, bazuar ky pretendim në lejet dhe licencat aktive të subjektit të publikuara në regjistrin zyrtar të Qendrës Kombëtare të Licencimit.*
8. *Përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" nuk plotëson kriterin për punonjësit në sektorin e shërbimit për vitin 2016, pasi numri i të punësuarve nuk përmbush kriterin e përqindjes së pjesëmarrjes së Clean Fast në Marrëveshjen e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë. Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 74, pika 3[...]*
9. *Përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" nuk plotëson kriterin për mjetet dhe pajisjet pasi nuk ka vërtetuar se disponon fshesë teknologjike sipas kërkesave të parashikuara në shtojcën 8 të DST-së.*
10. *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk plotëson kriterin për leje mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për pastrimin, sistemimin e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, bazuar ky pretendim në lejet dhe licencat aktive të subjektit të publikuara në regjistrin zyrtar të Qendrës Kombëtare të Licencimit.*

11. Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk plotëson kriterin për dorëzimin e çertifikatave ISO 9001-2008/ISO 9001-2015; ISO 18001:2007; ISO 14001:2004/ISO 14001:2015; pasi çertifikatat nuk janë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

12. Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk plotëson kriterin për mjetet dhe pajisjet pasi nuk ka vërtetuar se disponon fshesë teknologjike sipas kërkesave të parashikuara në shtojcën 8 të DST-të.

KVO-ja në vlerësimi e kësaj oferte duhet të zbatonte nenin 74, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, ku parashikohet se "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje", dhe të skualifikonte bashkimin e operatorëve ekonomikë "Clean Fast" & "Duka".

Sa më sipër argumentuam, kërkojmë nga ana juaj të rishqyrtohet vlerësimi i ofertave dhe të skualifikohet nga kjo procedurë prokurimi bashkimi i operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k.

II.5. Në datën 19.06.2018, me shkresën nr. 591/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ofertën, ndërkohë që ankimuesi pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga ana e autoritetit kontraktor.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

1. Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dokumentacionin për të cilin operatori ankimues ka ngritur pretendimin konstaton se për sa I përket kapacitetit ekonomik dhe financiar, vërtetimi I lëshuar nga administrata tatimore për xhiron e realizuar nga ky operator ekonomik përfshin një aktivitet tregtar 1 vit e 11 muaj (afërshisht 2 vjet si biznes I ri). Xhiro mesatare e llogaritur për 2 vitet e fundit që përkon me periudhën dy vite të aktivitetit ekonomik të këtij operatori është (24.242.993 lekë), duke provuar në këtë mënyrë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për realizimin e kësaj procedurë. Bazojmë gjykimin tonë në nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 3, ku parashikohet se: "Secili prej anëtarëve të këaj bashkimi duhet të përmbushë kërkesat [...]"

Si dhe bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy anëtarëve të BOE Clean Fast dhe Duka neni 5, ndarja e punimeve dhe detyrimet ", rezulton se në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim të përcaktuar në akt marrëveshje, BOE plotëson kërkesat ekonomike, financiare profesionale dhe ato teknike.

Gjithashtu bazuar në nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", [...]"

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori "DUKA" SHPK konstatohet se operatori përmban në fushën e ushtrimit të aktivitetit të tij "Shërbime komunale të të gjitha llojeve", objekt aktiviteti i cili, në vlerësimin tonë e përfshin objektin që prokurohet në këtë procedurë.

*Për arsyet e mësipërme, kualifikimi për anëtarin e BOE, operatorin ekonomik "CLEAN FAST" SHPK është i bazuar në ligj dhe pretendimi i operatorit ekonomik "SORI-AL" SHPK për këtë pikë nuk pranohet.*

*3. Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dokumentacionin për këtë pretendim konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga BOE me anëtarë "DUKA" SHPK dhe "CLEAN FAST" SHPK, kanë të përcaktuar me anë të një deklaratë të dorëzuar në SPE drejtuesin teknik të punimeve. Rezulton se dokumentacioni për punësimin e Agro-Ekologjist/Agronom ka qënë i plotë në përputhje me DST. Për arsyet e mësipërme, kualifikimi për anëtarin e BOE, operatorin ekonomik "CLEAN FAST" SHPK është i bazuar në ligj dhe pretendimi i operatorit ekonomik "SORI-AL" SHPK për këtë pikë nuk pranohet.*

*4. Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dokumentacionin për këtë pretendim konstaton se mosparuqitja e deklaratës nga anëtari i BOE "DUKA" SHPK plotësohet nëpërmjet deklaramit të bërë në kontratën e bashkëpunimit midis dy anëtarëve të BOE "CLEAN FAST" SHPK dhe "DUKA" SHPK, neni 5 "Ndarja e punimeve dhe detyrimet", ku është përcaktuar qartë angazhimi dhe përdorimi i të gjitha mjeteve dhe pajisjeve që duhen për realizimin e shërbimit dhe përmbushjen e kontratës për këtë procedurë, nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë e konkretisht si vijon: të dy shoqëritë do të ofrojnë të gjitha mjetet logjistike kapacitetet financiare, si dhe eksperiencën e tyre si një grup I vetëm pavarësisht nga pjesëmarrja për realizimin sa më mirë të kontratës. Mjetet dhe specialistët që disponohen nga secila palë dhe që janë të deklaruara në këtë procedurë prokurimi pavarësisht nga ndarja e punimeve do të përdoren pa pengesa nga secila palë duke i konsideruar si pronë e gjithë grupit deri në përfundimin e kontratës.*

*5. Komisioni i Shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dokumentacionin për të cilin operatori ankimues ka ngritur pretendimin, konstaton se për sa i përket kapacitetit ekonomik dhe financiar, Clean Fast shpk (pjesëmarrja 70%) në bashkimin e operatorëve ekonomikë (BOE) ka paraqitur kopjet e çertifikuara të bilanceve të dy viteve 2016, 2017 të miratuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore, që përkojnë me periudhën dy vjeçare të aktivitetit ekonomik të këtij operatori ashtu si edhe ju keni cituar.*

*Vlerësojmë se operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k. është një biznes i ri dhe konstatojmë se për vitet që ai ushtron aktivitetin ka vërtetuar kapacitete me rritje të konsiderueshme në fushën e veprimtarisë të cilës ushtron. Në vetvete kriteri për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit nga operatorët pjesëmarrës, kërkohet për të provuar ecurinë, kredibilitetin dhe potencialet tregtare-ekonomike të operatorëve ekonomikë për fushat respektive në të cilat ata operojnë. Në rastin konkret operatori "Clean Fast" shpk e përmbush qëllimin thelbësor të këtij kriteri edhe në mungesë të bilancit të vitit 2015 duke e vlerësuar këtë mungesë si devijim i vogël, bazuar në pikën 4 të nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe gabime shtypi të cilat mund të korigjohen pa prekur përmbajtjen e saj".*

Në gjykimin tone mosparaqitja e bilancit të vitit 2015 nga anëtari i BOE "Clean Fast" sh.p.k. i cili e ka filluar aktivitetin e tij tregtar në qershor 2016, nuk e ndryshon thelbësisht qëllimin e kriterit të pretenduar, duke mbajtur parasysh se veprimtaria e këtij operatori për vitet 2016 dhe 2017 ka qënë në mënyre të konsiderueshme e suksesshme. Këtë gjykim e mbështesim edhe në LPP, nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes" ku parashikohet sc: "Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, "; në nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve". pika 1/c ku parashikohet se: "gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitete ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën. me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky Informacion është i mundur; " dhe pika 3: "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik ". Viojmë në mbështetje të nenit 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 3 ku parashikohet se: "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ata teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. " si dhe bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis dy anëtarëve të BOE "Clean Fast" SHPK dhe " Duka" SHPK, neni 5 "Ndarja e punimeve dhe detyrimet", rezulton se në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim të përcaktuar në akt marrëveshje, BOE plotëson kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike. Për gjithë arsyet e mësipërme, vlerësojmë se kualifikimi për anëtarin e BOE, operatorin ekonomik "CLEAN FAST" SHPK është i bazuar në ligj dhe pretendimi i operatorit ekonomik "SORI-AL" SHPK për këtë pikë nuk pranohet.

6. Nga verifikimi i dokumentacionit për këtë procedurë dhe hulumtimin për secilën prej çertifikatave të sipërpërmendura bazuar në rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe DPA-se "Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë" APP nr. 3330 datë 20.03.2018 dhe DPAnr. 145, datë 16.03.2018 hyrë në fuqi nga data 20.03.2018, konstatojmë se të gjitha çertifikata ISO të paraqitura nga operatori "CLEAN FAST" SHPK janë në përputhje me kriteret e kërkuara nga AK dhe rekomandimi I sipërcituar ne perputhje me kriteret e kërkuara nga AK dhe rekomandimi i sipërcituar.

7. Komisioni I shqyrtimit të ankeses pasi shqyrtoi dokumentacionin per kete pretendim konstaton se operatori "CLEAN FAST" SHPK e disponon dhe e ka dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit. lejen miedisone per realizimin e sherbimit dhe përmbushjen e kontratës për këtë procedure.

8. Përsa i takon pretendimin të kësaj pike ju bëjmë me dije se përsa I përket kapacitetit ekonomik financiar, kemi shqyrtuar listëpagesat e lëshuara nga administrate tatimore për këtë operator ekonomik I cili ka një aktivitet tregtar prej 1 vit e 11 muaj (afërsisht 2 vjet si biznes i ri).



Me një përlllogaritje është vënë re se ky operator ka pasur në vijim shumë më tepër numër punonjësish (nga ajo që është kërkuar) duke e bërë këtë operator të besueshëm në realizimin me sukses të kësaj kontrate mbështetur kjo në pikën 4 të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” [..] dhe nenin 2 [..] nenin 46 “Kualifikimi i ofertave”[...] dhe pika 3

9. Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dokumentacionin për këtë pretendim konstaton se ky kriter është plotësuar nga BOE me anëtarë operatorin “CLEAN FAST” SHPK dhe operatorin “DUKA” SHPK. BOE e disponojnë dhe e kanë dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit dokumentacionin për të gjitha mjetet dhe pajisjet që duhen për realizimin e shërbimit dhe përmbajtjen e kontrates për këtë procedurë, sipas kërkesave të AK. Në kontratën e bashkëpunimit vet operatorët kanë përcaktuar ndarjen e punimeve, ku shoqëria “CLEAN FAST” SHPK do të realizojë vetëm zërat e punimeve që konsistojnë në pastrimin e brendshëm. bazuar në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 74 “Bashkimi i operatoreve ekonomik”, pikës 3, ku pamhikohet se[...]

10. Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dokumentacionin për këtë pretendim konstaton se operatori “DUKA” SHPK e disponon dhe e ka dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit, lejen mjedisore për realizimin e shërbimit dhe përmbushjen e kontratës për këtë procedurë.

11. Nga verifikimi i dokumentacionit për këtë procedurë dhe hulumtimi për secilën prej certifikatave ISO të sipërpermendura, bazuar në rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe DPA-së, “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë” APP Nr. 3330 datë 20. 03.2018 dhe DPA Nr, I45 datë 16.03.2018 hyrë në fuqi nga data 20.03.2018, konstatohet se të gjitha certifikata ISO të paraqitura nga operatori “DUKA” SHPK janë në përputhje me kriteret e kërkuar nga AK dhe rekomandimi i sipërcituar. Për arsyet e mësipërme, kualifikimi për anëtarin e BOE, për operatorin ekonomik “CLEAN FAST” SHPK është i bazuar në ligj dhe pretendimi i operatorit ekonomik “SORI-AL” SHPK për këtë pikë nuk pranohet.

12. Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi shqyrtoi dokumentacionin për këtë pretendim konstaton se ky kriter është plotësuar nga BOE me anëtarë operatorin “CLEAN FAST” SHPK dhe operatorin “DUKA” SHPK. Rezulton se operatori “DUKA” SHPK e disponon dhe e ka dorëzuar në sistemin elektronik të prokurimit dokumentacionin për të gjitha mjetet dhe pajisjet që duhen për realizimin e shërbimit dhe përmbushjen e kontratës për këtë procedurë, sipas kërkesave të AK. [...]

II.6. Në datën 25.06.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

[...]

1. Ofertuesi “Clean Fast” nuk plotëson kriterin për paraqitjen e bilancit të vitit 2015, bazuar ky pretendim në ekstraktin e regjistrit tregtar të shoqërisë “Clean Fast” sh.p.k. ku vërtetohet se ky operator është regjistruar në datën 07.06.2016 (bashkëlidhur kopje e ekstraktit të shoqërisë). Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 74 “Bashkimi i Operatoreve ekonomikë” pikës 3, ku parashikohet se:



*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.*

2. *Ofertuesi Clean Fast nuk plotëson kriterin për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, pasi vlera mesatare e xhiros së tij nuk plotëson vlerën sipas përqindjes së pjesëmarrjes në marrëveshjen e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “Bashkimi i Operatorëve ekonomikë”, pikës 3, ku parashikohet [...]*
3. *Përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” nuk plotëson kriterin për dorëzimin e çertifikatave ISO 9001-2008/ISO 9001-2015; ISO 18001:2007; ISO 14001:2004/ISO 14001:2015; pasi çertifikatat nuk janë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*
4. *Përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” nuk plotëson kriterin për leje mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për pastrimin, sistemimin e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, bazuar ky pretendim në lejet dhe licencat aktive të subjektit të publikuara në regjistrin zyrtar të Qendrës Kombëtare të Licencimit.*
5. *Përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” nuk plotëson kriterin për punonjësit në sektorin e shërbimit për vitin 2016, pasi numri i të punësuarve nuk përmbush kriterin e përqindjes së pjesëmarrjes së Clean Fast në Marrëveshjen e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë. Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 74, pika 3[...]*
6. *Përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” nuk plotëson kriterin për mjetet dhe pajisjet pasi nuk ka vërtetuar se disponon fshesë teknologjike sipas kërkesave të parashikuara në shtojcën 8 të DST-së.*
7. *Operatori ekonomik “Duka” sh.p.k. nuk plotëson kriterin e kapacitetit ligjor pasi në ekstraktin e regjistrit të shoqërisë nuk përfshihet objekti që prokurohet “Pastrim i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme”. Ky pretendim bazohet në ekstraktin e shoqërisë shkarkuar nga QKB ku përcaktohet se objekt i veprimtarisë së shoqërisë “Duka” sh.p.k. është: “Prodhim të materialeve të ndërtimit, ndërtime e shtrime rrugësh, punime dhe gërmime me makina të rënda, pune rrugësh dhe digash, shtrimesh, ndërtimit, servis makinash, pjesë këmbimi dhe çdo lloj tjetër punimi objektesh Shërbime komunale të të gjitha llojeve, tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, etj., Diferencim, riciklim i mbeturinave urbane. Vlerësim i ndikimit dhe impakti në mjedis, auditim dhe ekspertizë mjedisore, studim, projektim dhe zbatim të projekteve mjedisore.*
8. *Operatori ekonomik “Duka” sh.p.k. nuk plotëson kriterin për leje mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për pastrimin, sistemimin e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, bazuar ky pretendim në lejet dhe licencat aktive të subjektit të publikuara në regjistrin zyrtar të Qendrës Kombëtare të Licencimit.*

9. *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk ka dorëzuar deklaratë për drejtuesin teknik për kryerjen e shërbimit të marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka vërtetuar se ka të punësuar Agro – Ekologjist/Agronom duke mos dorëzuar kontratë pune/librezë pune /diplomë. Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 74, pika 3[...]*
10. *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk ka dorëzuar deklaratë për disponimin e mjeteve që do të angazhohen në këtë procedurë prokurimi.*
11. *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk plotëson kriterin për dorëzimin e çertifikatave ISO 9001-2008/ISO 9001-2015; ISO 18001:2007; ISO 14001:2004/ISO 14001:2015; pasi çertifikatat nuk janë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*
12. *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk plotëson kriterin për mjetet dhe pajisjet pasi nuk ka vërtetuar se disponon fshesë teknologjike sipas kërkesave të parashikuara në shtojcën 8 të DST-të.*

*KVO-ja në vlerësimi e kësaj oferte duhet të zbatonte nenin 74, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, ku parashikohet se "Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje", dhe të skualifikonte bashkimin e operatorëve ekonomikë "Clean Fast" & "Duka".*

*Sa më sipër argumentuam, kërkojmë skualifikimin nga kjo procedurë prokurimi të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k.*

II.7. Në datën 12.07.2018, nëpërmjet shkresës me nr.671/1 prot., datë 09.07.2018, me objekt: "Dërgim dokumentacioni për Lotin II: "Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "Sori – AI" sh.p.k.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik konstatohet se autoriteti kontraktor në procesverbalin e mbajtur nga KVO për vlerësimin e ofertave, dhe konkretisht BOE "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k. është shprehur si më poshtë vijon:

- *Në lidhje me kriterin "Leje mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për pastrimin, sistemimin e ambjenteve të brendshme dhe të jashtme", e përcaktuar në pikën 2.4 "Licencat profesionale" të Kritereve të Vecanta për Kualifikim të DT, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të mos ta marrë në vlerësim këtë kriter, sepse bazuar në ligjin nr.60/2014 "Për një ndryshim në ligjin nr.10448 datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, Shtojca 1 "Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi", nuk parashikohet lëshimi nga ana e QKB-së e një leje mjedisore të tipit C për aktivitetin "pastrim, sistemim i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme".*

*Për më tepër sqarojmë se kjo lloj veprimtarie (pastrimi, sistemimi), nuk ka ndikim negativ në mjedis, në mënyrë që operatori ekonomik të pajiset me leje mjedisore nga institucioni përkatës QKB.*

- *Ne lidhje me kapacitetin ligjor/profesional të anëtarit të BOE Duka shpk, KVO sqaron se ne fushën e ushtrimit të aktivitetit ky operator ekonomik sipas ekstraktit të QKB ka "Sherbime komunale të të gjitha llojeve", objekt aktiviteti i cili përfshin objektin që prokurohet "Pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme".*
- *Në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar të anëtarit të BOE Clean Fast shpk (pjesëmarrja 70%), KVO sqaron se vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore për xhiron e realizuar nga ky operator ekonomik përfshin një aktivitet tregtar 1 vit e 11 muaj (afërsisht 2 vjet si biznes i ri). Xhiro mesatare e llogaritur për 2 vitet e fundit që përkon me periudhën dy vite të aktivitetit ekonomik të këtij operatori, është në vlerën 27.290.459,5 lekë, pra një vlerë me e lartë se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në BOE (24.242.993 lekë), duke provuar në këtë mënyrë pasjen e kapacitetit të nevojshëm ekonomik dhe financiar për realizimin e kësaj procedure.*
- *Në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar të anëtarit të BOE Clean Fast shpk (pjesëmarrja 70%), KVO sqaron se janë paraqitur kopjet e çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit 2016, 2017 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, që përkojnë me periudhën dy vjecare të aktivitetit ekonomik të këtij operatori.*

*Sa më sipër, KVO konsideron devijime të vogla bazuar në pikën 4 të nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj ", mosparaqitjen e bilancit të vitit 2015 dhe xhiron për vitin 2015 nga anëtari i BOE Clean Fast shpk, i cili e ka filluar aktivitetin e tij tregtar në qershor 2016. Vlerësimi si devijime të vogla mbështetet edhe në LPP, nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes" ku parashikohet se: "Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, "; në nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika l/c ku parashikohet se: "gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur dhe pika 3: "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik".*

Po ashtu, në mbështetje të nenit 74 të RPP, pika 3 ku parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike financiare profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim, apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje si dhe bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy anëtarëve të BOE Clean Fast shpk dhe Duka shpk, neni 5 “Ndarja e punimeve dhe detyrimet”, rezultoi se në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim të përcaktuar në akt marrëveshje BOE plotëson kërkesat ekonomike, financiare profesionale dhe ato teknike.

- Në lidhje me “Shënim: Deklaratë nga administratori I shoqërisë që mjetet e propozuara nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër dhe do të përdoren për realizimin e këtij shërbimi gjatë gjithë kohezgjatjes së kontratës”, KVO sqaron se mosparaqitja e deklaratës nga anëtari i BOE Duka shpk vlerësohet si devijim i vogël bazuar në pikën 4 të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Autoriteti kontraktor vlerëson një oferte të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e qera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.”. Kjo kërkesë plotësohet nëpërmjet deklaratimit të bërë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis dy anëtarëve të BOB Clean Fast shpk dhe Duka shpk, neni 5 “Ndarja e punimeve dhe detyrimet”, ku është përcaktuar qartë angazhimi dhe përdorimi I të gjitha mjeteve dhe pajisjeve që duhen për realizimin e shërbimit dhe përmbushjen e kontratës për këtë procedurë, nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik (BOE), e konkretisht si vijon: Te dy shoqëritë do të ofrojnë me gjitha mjetet logjistike, kapacitetet financiare si dhe eksperiencën e tyre si një grup i vetëm pavarësisht nga pjesëmarrja për realizimin sa më mirë të kontratës. Mjetet dhe specialistet që disponohen nga secila palë dhe që janë deklaruar në këtë procedurë prokurimi pavarësisht nga ndarja e punimeve do të përdoren pa pengesa nga secila palë duke i konsideruar si prone të gjithë grupit deri në perfundimin e kontratës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...]Ofertuesi Clean Fast nuk plotëson kriterin për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, pasi vlera mesatare e xhiros së tij nuk plotëson vlerën sipas përqindjes së pjesëmarrjes në marrëveshjen e bashkimit të operatorëve ekonomikë. Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “Bashkimi i Operatorëve ekonomikë”, pikës 3, ku parashikohet [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 2.3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *“Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, duke filluar nga nga data e hapjes së ofertave, ku vlera mesatare e xhiros gjatë të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti”*.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Clean Fast” sh.p.k. dhe shoqërisë ”Duka” sh.p.k., nga ku shoqëria “Clean Fast” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 70% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria ”Duka” sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 30% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Clean Fast” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Konkretisht zërat e punimeve të preventivit referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së cituar më sipër janë ndarë si më poshtë vijon:

**Shoqëria ”Clean Fast” sh.p.k. do të realizojë konkretisht:**

- A. *Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT);*
- B. *Pastrim i brendshëm me shërbim 24 – orësh ( 8600.4x3 turne ) (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*
- C. *Shërbimi DDD (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike DT)*
- D. *Shërbimi mujor i pastrimit të fasadës (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*

**Shoqëria ”Duka” sh.p.k. do të realizojë këto zëra punimesh:**

- A. *Sipërfaqet e jashtme për t’u pastruar (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*
- B. *Sipërfaqet e jashtme për tu larë (sipas termave të referencës dhe specifikimeve në DT)*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ”Clean Fast” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të sipërcituar, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vërtetim (për xhiron e tre viteve të fundit) me nr. T00303090, datë 17.05.2018 ku konstatohet se: *”në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitura për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave / shërbimeve si më poshtë:*

Nr.	Periudha Tatimore	Shuma
1.	17-A	45,431,559
2.	16-A	9,149,360

- Ekstrakti i regjistrimit tregtar nga ku konstatohet se kjo shoqëri është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në datën 07.06.2016.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti*

*kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.* Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.8. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.



III.1.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik "Clean Fast" sh.p.k. rezulton se, ky i fundit ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për vitin 2016 dhe për vitin 2017, nga tre vitet e fundit të kërkuar në kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, përkatësisht në vlerat prej: 9,149,360 lekë dhe 45,431,559 lekë dhe në raport me kriterin e kërkuar në DST ka një xhiro mesatare për tre vite në vlerën 18.193.639,66 lekë.

III.1.10. Referuar ekstraktit të regjistrimit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit rezulton se operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k. është krijuar si shoqëri në Qershor të vitit 2016 dhe dokumentacioni që ka paraqitur në lidhje me xhiron i përket respektivisht viteve 2016 dhe 2017. Nisur nga kjo, xhiro për vitin 2015 (në respekt të kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit që kërkohet xhiro mesatare e realizuar gjatë tri viteve të fundit), rrjedhimisht në përlllogaritje të mesatares do të konsiderohet në shifrën 0 lekë për shkak të mosekzistencës së kësaj shoqërie në këtë vit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar dokumentacionit të paraqitur (si mësipër analizuar), sipas të cilit operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k. si pjesë e bashkimit të përkohshëm ka marrë përsipër të kryejë 70% të volumit, kriteri specifik për xhiron mesatare të tre viteve (2015, 2016, 2017) nuk përmbushet, duke mos qenë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor dhe rregullat e prokurimit publik si më sipërcituar, si edhe akt marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy shoqërive.

III.1.11. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k. si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk plotësohet kërkesa për xhiron mesatare vjetore në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "Sori – Al" sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk plotëson kriterin e kapacitetit ligjor pasi në ekstraktin e regjistrimit të shoqërisë nuk përfshihet objekti që prokurohet "Pastrim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme". Ky pretendim bazohet në ekstraktin e shoqërisë shkarkuar nga QKB ku përcaktohet se objekt i veprimtarisë së shoqërisë "Duka" sh.p.k. është: "Prodhim të materialeve të ndërtimit, ndërtime e shtrime rrugësh, punime dhe gërmime me makina të rënda, pune rrugësh dhe digash, shtrimesh, ndërtimit, servis makinash, pjesë këmbimi dhe çdo lloj tjetër punimi objektsh Shërbime komunale të të gjitha llojeve, tregtim me shumicë e pakicë të artikuljeve të ndryshëm industrial, ushqimor, etj., Diferencim, riciklim i mbeturinave urbane. Vlerësim i ndikimit dhe impakti në mjedis, auditim dhe ekspertizë mjedisore, studim, projektim dhe zbatim të projekte mjedisore, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 1, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *"Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".*

b) *nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*

b) *nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*

c) *nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

d) *ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim".*

Gjithashtu në Shtojcën 8, Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *"Ne lidhje me piken e mesiperme operatorit ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokument zyrtar (Ekstraktin tregetar ose ekstraktin historik të subjektit të leshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit), me ane të cilës të vertetohet që fusha ose një nga fushat e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik ofertues të përfshijë objektin që prokurohet "Pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme".*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë "Clean Fast" sh.p.k. dhe shoqërisë "Duka" sh.p.k., nga ku shoqëria "Clean Fast" sh.p.k. merr përsipër të realizojë 70% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria "Duka" sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 30% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Clean Fast" sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Konkretisht zërat e punimeve të preventivit referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së cituar më sipër janë ndarë si më poshtë vijon:

**Shoqëria "Clean Fast" sh.p.k. do të realizojë konkretisht:**

- E. *Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT);*
- F. *Pastrim i brendshëm me shërbim 24 – orësh ( 8600.4x3 turne ) (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*
- G. *Shërbimi DDD (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike DT)*
- H. *Shërbimi mujor i pastrimit të fasadës (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*

**Shoqëria "Duka" sh.p.k. do të realizojë këto zëra punimesh:**

- C. *Sipërfaqet e jashtme për t'u pastruar (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*
- D. *Sipërfaqet e jashtme për tu larë (sipas termave të referencës dhe specifikimeve në DT)*

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Duka" sh.p.k. rezulton se në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumentacioni si më poshtë vijon:

- Shtojca 7 Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ku deklarohet se "Operatori "Duka" sh.p.k. është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. [...]".
- Ekstraktin e regjistrimit tregëtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", ku në pikën 9 të saj Objekti i aktivitetit, evidentohet objekti "Prodhim të materialeve të ndërtimit, ndërtim e shtrime rrugësh, punime dhe gërmime me makina të rënda, punë rrugësh dhe digash, shtrimesh, ndërtimit, servis makinash, pjesë këmbimi dhe çdo lloj tjetër punimi objektësh Shërbime komunale të të gjitha llojeve, tregtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimorë etj., Diferencim, riciklim i mbeturinave urbane, Vlerësimi i ndikimit dhe impakti në mjedis, auditim dhe ekspertizë mjedisore, studim, projektim dhe zbatim të projekteve mjedisore".

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

III.2.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.2.7. Në Kreun VIII, neni 74, *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”*, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.2.8. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.2.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik *“Duka”* sh.p.k. rezulton se ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit tregtar, në të cilin nuk konstatohet të ketë si veprimtari shërbimin e pastrimit të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, ashtu siç është kërkuar shprehimisht në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

III.2.10. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë *“Clean Fast”* sh.p.k. & *“Duka”* sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga operatori ekonomik *“Duka”* sh.p.k. nuk plotësohet kërkesa për objektin e veprimtarisë së shoqërisë në fushën e pastrimit të ambjenteve të brendshme e të jashtme, sipas

kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "Sori – Al" sh.p.k. qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk ka dorëzuar deklaratë për drejtuesin teknik për kryerjen e shërbimit të marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë si dhe nuk ka vërtetuar se ka të punësuar Agro – Ekologjist/Agronom duke mos dorëzuar kontratë pune/librezë pune /diplomë. Mosplotësimi i këtij kriteri vjen në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 74, pika 3[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 2.5. Kërkesat profesionale të personelit kryesor, pika 1, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *"Operatori ekonomik duhet te kete drejtues teknik per kryerjen e ketij sherbimi me profesion Agro-Ekologjist/Agronom, i cili duhet te kete minimalisht 5 vjet eksperience pune, te vertetuar me kontrate pune, libeze pune, diplome. Operatori ekonomik duhet te percaktoje drejtuesin teknik nepermjet nje deklarate me shkrim"*.

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë "Clean Fast" sh.p.k. dhe shoqërisë "Duka" sh.p.k., nga ku shoqëria "Clean Fast" sh.p.k. merr përsipër të realizojë 70% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria "Duka" sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 30% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Clean Fast" sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Konkretisht zërat e punimeve të preventivit referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së cituar më sipër janë ndarë si më poshtë vijon:

**Shoqëria "Clean Fast" sh.p.k. do të realizojë konkretisht:**

- I. *Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT);*
- J. *Pastrim i brendshëm me shërbim 24 – orësh ( 8600.4x3 turne ) (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*
- K. *Shërbimi DDD (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike DT)*
- L. *Shërbimi mujor i pastrimit të fasadës (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*

**Shoqëria "Duka" sh.p.k. do të realizojë këto zëra punimesh:**

- E. *Sipërfaqet e jashtme për t'u pastruar (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*
- F. *Sipërfaqet e jashtme për tu larë (sipas termave të referencës dhe specifikimeve në DT)*

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Shtojca - Deklaratë mbi përcaktimin e drejtuesit teknik, deklaratë kjo e paraqitur nga Administratori i shoqërisë "Clean Fast" sh.p.k., sipas së cilës përcaktohet drejtues teknik për ndjekjen e kësaj kontrate z. F.I. i diplomuar si agronom i lartë;
- Kontratë pune ndërmjet shoqërisë "Clean Fast" sh.p.k. dhe z. F.I. për detyrën e Drejtuesit Teknik, shoqëruar me diplomë, listë notash, librezë pune, çertifikatë, librezë pune, CV,

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*".

III.3.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*".

III.3.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.



Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.3.7. Në Kreun VIII, neni 74, "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: "*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi*". Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: "*Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...*", ndërsa në pikën 3 parashikohet: "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*".

III.3.8. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.3.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k. rezulton se në lidhje me plotësimin e kriterit të sipërcituar ka paraqitur dokumentacion vetëm operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k. si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k., dhe nuk është paraqitur asnjë dokumentacion nga ana e anëtarit tjetër të këtij bashkimi "Duka" sh.p.k. në përputhje me përqindjen dhe zërat e punëve që ka marrë përsipër për të kryer në kontratën e bashkëpunimit.

III.3.10. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga njëri prej operatorëve ekonomikë anëtarë të bashkimit nuk plotësohet kërkesa për drejtuesit teknik, duke mos u paraqitur prej tij as deklaratat për drejtuesin teknik dhe as dokumentacioni përkatës i kërkuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor në lidhje me të, në përputhje me zërat e shërbimit të marra përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Clean Fast" sh.p.k. & "Duka" sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "Sori – Al" sh.p.k. qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] *Operatori ekonomik "Duka" sh.p.k. nuk ka dorëzuar deklaratë për disponimin e mjeteve që do të angazhohen në këtë procedurë prokurimi*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, pika 2.6. nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: “

2.6. *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike (makineri dhe pajisje) që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si me poshte:*

*Operatori ekonomik duhet të disponojë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme:*

TABELA NR 1

LISTA E MJETEVE DHE PAISJEVE

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Makinë larëse	copë	2
2	Fshese teknologjike	copë	1
3	Kosha të vegjël mbeturinash anës rrugëve	copë	18
4	Karroca Profesionale për shërbimin e pastrimit	copë	5

*Shënim: Makineri – pajisjet:*

- *Makineri - pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi) dhe leje qarkullimi, kolaudim e sigurim i detyrueshem i mjeteve motorrike per automjetet.*
- *Makineri - pajisjet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve me afat jo me vone se hapja e ofertave dhe deri ne*

*përfundim të kontratës dhe leje qarkullimi, kolaudim e sigurim i detyrueshem i mjeteve motorike per automjetet.*

- *Deklaratë nga administratori i shoqërisë që mjetet e propozuara nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër dhe do të përdoren për realizimin e këtij shërbimi gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.*

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Clean Fast” sh.p.k. dhe shoqërisë ”Duka” sh.p.k., nga ku shoqëria “Clean Fast” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 70% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria ”Duka” sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 30% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Clean Fast” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Konkretisht zërat e punimeve të preventivit referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së cituar më sipër janë ndarë si më poshtë vijon:

**Shoqëria ”Clean Fast” sh.p.k. do të realizojë konkretisht:**

*M. Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT);*

*N. Pastrim i brendshëm me shërbim 24 – orësh ( 8600.4x3 turne ) (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*

*O. Shërbimi DDD (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike DT)*

*P. Shërbimi mujor i pastrimit të fasadës (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*

**Shoqëria ”Duka” sh.p.k. do të realizojë këto zëra punimesh:**

*G. Sipërfaqet e jashtme për t’u pastruar (sipas termave të referencës dhe specifikimeve teknike në DT)*

*H. Sipërfaqet e jashtme për tu larë (sipas termave të referencës dhe specifikimeve në DT)*

III.4.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Deklaratë e operatorit ekonomik ”Clean Fast” sh.p.k., ku deklarohej se: *”Të gjitha mjetet dhe pajisjet e paraqitura për plotësimin e kapaciteteve teknike të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Këto pajisje dhe mjete do të jenë në dispozicion të realizimit të kësaj kontrate që nga momenti i lidhjes së kontratës, nëse Clean Fast sh.p.k. shpallet fitues, deri në përfundimin e plotë të saj”.*

III.4.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.4.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet:

*“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.4.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.4.7. Në Kreun VIII, neni 74, *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”*, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.*

*Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.4.8. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.4.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik *“Duka”* sh.p.k. rezulton se ky i fundit në përmbushje të kriterit për mjetet ka paraqitur dokumentacion në lidhje me mjetet: autofshesë, autobot, për të cilat nuk ka paraqitur deklaratën përkatëse të mosangazhimit të tyre në kontrata të tjera gjatë realizimit të kësaj kontrate.

III.4.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, referuar dokumentacionit të paraqitur (si mësipër analizuar), sipas të cilit operatori ekonomik “Duka” sh.p.k. si pjesë e bashkimit të përkohshëm ka marrë përsipër të kryejë 30% të volumit, kriteri në lidhje me mjetet/ deklaratën e angazhimit të tyre në kontrata të tjera ose jo, nuk përmbushet, duke mos qenë në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor dhe rregullat e prokurimit publik si më sipërcituar, si edhe akt marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy shoqërive.

III.4.11. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga operatori ekonomik “Duka” sh.p.k. si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k., në kushtet kur ka marrë përsipër 30% të preventivit dhe ka paraqitur disa mjete për të realizuar atë pjesë të shërbimit që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit, nuk është paraqitur deklarata nga administratori i shoqërisë që mjetet e propozuara nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër dhe do të përdoren për realizimin e këtij shërbimi gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Sori – Al” sh.p.k. qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “Sori - Al” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interes të ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sori - AI” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-63369-04-18-2018, Loti II, me objekt “Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 86.582.118. lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara – Ministria e Brendshme.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Clean Fast” sh.p.k. & “Duka” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sori - AI” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1183 Protokolli**

**Datë 25.06.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**